



Pranuar / Dorezuar Prilapen/Prilapen Received/Delivered	09.09	2	viti god year
Organ /Rjeshta Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/MLK	5298/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.668/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.668/2022 të datës 27.07.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

Prishtinë, kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës në çështjen juridike-administrative “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 09.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa A.nr.668/2022 e datës 27.07.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. *Obligohet* Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për rregullimin e statusit të ankuesit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë.
- III. *Obligohet* Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që të siguroj zbatimin e vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës më datë 27.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër përgjigjes me numër protokoll 793 të datës 19.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shkak të moszbatimit të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.08.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 17.08.2022 ka dorëzuar shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 27.07.2022 me numër protokolli 4338/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga për ankesa.kpmsk@rks-gov.net i datës 27.07.2022; Kërkesë për shndërrimin e marrëdhënies së punës në kohë të pacaktuar (akt emërim) me nr. protokolli 793 i datës 15.07.2022; Përgjigje në kërkesën me nr. protokolli 793 i datës 19.07.2022; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar i i datës 16.02.2018; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar i i datës 19.02.2013; Vlerësimi i Rezultateve në Punë i i datës 31.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2020 i i datës 01.02.2021; E-mail nga Drejtorja SHKK për datës 27.07.2022; Formulari i regjistrimit të ankesës; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 05.08.2022; Përgjigje në ankesë i datës 22.08.2022; E-mail nga për i datës 17.08.2022; Shkresë e lëndës për ankesën A.nr.668/2022 i datës 17.08.2022; Rekomandimi për përtëritjen e kontratës i datës 18.01.2018;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së është e bazuar ankesa e ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale të lëndës rrjedhë se ankuesi në bazë të Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, fillimisht më datë 19.02.2013 përmes Kontratës së Punës për kohë të caktuar ka themeluar marrëdhënie të punës me Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën e punës Drejtor i Qendrës Korrektuese në Dubravë për periudhën nga data 19.02.2013 deri më datë 18.02.2018, ndërsa sipas Kontratës së Punës për kohë të caktuar të datës 16.02.2018, ankuesit i është vazhduar marrëdhënia e punës në pozitë Drejtor në Qendrën Burgu i Sigurisë së Lartë me kohëzgjatje nga data 19.02.2018 deri më datë 18.02.2023.

Ankuesi më datë 19.07.2022 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 793 të Menaxheri i Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shndërrimin e kontratës së punës në akt emërim të përhershëm duke u bazuar në nenin 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, ndërsa në përgjigje të kërkesës së ankuesit Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes shkresës me numër protokolli 793 të datës 19.07.2022 ka refuzuar kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se ankuesi ka themeluar marrëdhënie të punës në bazë të dispozitave të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale me afat të caktuar, andaj edhe kontrata e punës me afat nuk mund të kthehet me afat të pa caktuar. Ankuesi i pakënaqur me këtë përgjigje, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të moszbatimit të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë nga organi i punësimit, duke shtuar më tej se mos rregullimi i marrëdhënies së punës respektivisht mos shndërrimi i kontratës së punës me afat të caktuar në akt emërim të përhershme është në kundërshtim me nenin 32

paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të obligoj Shërbimin Korrektues të Kosovës që ankuesit t'i rregulloj marrëdhënien e punës me akt emërim me afat të pacaktuar.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngrit pretendimet ankimore, gjegjësisht dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civil me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë*, dhe si rrjedhojë konstatoi se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civil me status të veçantë duke nënkuptuar se marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë, dhe ligjit të veçantë. Në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit rregullimi me ligj të veçantë i elementeve nga marrëdhënia e punës duhet të jetë në pajtueshmëri me parimet e përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe mund të rregullohen ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: kushtet e veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; zhvillimi profesional dhe nevojat për trajnime; transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve.

Ndërsa, përkitazi me rregullimin e statusit të zyrtarëve publikë, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat tranzitore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht Nenin 83 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Një punonjës aktual, që nuk e ka statusin e nëpunësit civil sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L-149), por që e mban një pozitë, e cila është pozitë e Shërbimit Civil për nga funksionet dhe përgjegjësitë sipas nenit 2, paragrafit 3 të këtij ligji, do të emërohet si nëpunës civil sipas këtij ligji, nëse i plotëson këto kushte: 2.1. ka qenë në marrëdhënie pune në një institucion të administratës shtetërore apo në një institucion tjetër shtetëror së paku dy vjetët e fundit para hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. i plotëson kërkesat e nenit 8 të këtij ligji, dhe 2.3. është vlerësuar për rezultatet në punë në këto dy vjet të paktën "mirë", dhe paragrafin 16 po të të njëjtit nen ku përcaktohet se: Deklarimi apo rregullimi i statusit të punësimit të çdo personi, sipas paragrafëve 1- 8 të këtij neni, bëhet me propozim të institucionit dhe me miratimin e Njesisë përgjegjëse, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedura e deklarimit/rregullimit zhvillohet sipas Ligjit për Procedurën Administrative.*

Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, si dhe duke ju referuar nenit 8 të po të njëjtit ligj, Kolegji i Këshillit konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për rregullimin e statusit të zyrtarit publikë për ankuesin, për faktin se ashtu siç është konstatuar më lartë i njëjti është në marrëdhënie të punës në Shërbimin Korrektues të Kosovës, nga data 19.02.2013, dhe rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës ankuesi është vlerësuar për vitin 2020 me notë të përgjithshme 4.1, kurse për vitin 2021 me notë të përgjithshme 3.85, duke u vlerësuar kështu dy (2) vite radhazi me notë "shumë mirë", dhe se nuk ka dëshmi se ankuesi ka në fuqi masë disiplinore "largim nga një pozitë e zyrtarit publik" apo se i njëjti është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi në dispozitiv të këtij Vendimi.




Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.668/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

